



**bashkëpunimi
gjerman**
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



BASHKIA
KORÇË

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2022-2025

Bashkia Korçë

Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2022-2025 u hartua nga Grupi i punës si më poshtë, me mbështetjen e Programit Global “Migracioni & Diaspora”, i financuar nga Qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GIZ.

Grupi i punës

- | | |
|----------------------------|------------------------------|
| 1. Etelka Ilia | Bashkia Korçë |
| 2. Klajdi Jaçe | Bashkia Korçë |
| 3. Klaudia Punemira | Bashkia Korçë |
| 4. Anxhela Taho | DRFPP Korçë |
| 5. Valmira Guzi | Ekspert - Key Adviser |
| 6. Mariel Hysa | Ekspert - Key Adviser |

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE.....	3
HYRJE	4
METODOLOGJIA	6
KUADRI STRATEGJIK NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR.....	8
PLANET VENDORE TË BASHKISË KORÇË.....	11
PROFILI I BASHKISË KORÇË.....	13
ANALIZA S.W.O.T	15
QËLLIMI I PLANIT VENDOR.....	17
VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS	18
OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR KORÇË	19
PLANI I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2022-2025	24
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT	44

LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BK	Bashkia Korçë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHBD	Dhoma e Biznesit të Diasporës
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GCM	Global Compact for Migration
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SMD	Struktura e Migracionit dhe Diasporës

HYRJE

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën në bashkinë Korçë, është mbështetur nga Programit Global “Migracioni & Diaspora”, i financuar nga Qeveria Gjermane dhe i zbatuar nga GIZ.

Për hartimin e këtij plani janë marrë për bazë parashikimet e kuadrit ligjor kombëtar e vendor, si ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe planet e tjera të përgjithshme apo vendore të bashkisë Korçë.

Plani është hartuar bazuar në nevojat që autoritetet vendore kanë lidhur me ndryshimet e fundit që pësoi ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Për këtë arsye, ky plan vendor është një vlerë e shtuar e bashkisë Korçë, për të përmirësuar qeverisjen vendore duke përfshirë dhe migracionin e diasporën në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve dhe projekteve që kanë të bëjnë me ta.

Me ndryshimet e fundit në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, konkretisht me ndryshimet e nenit 29/1 të ligjit, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 456 datë.10.06.2020 “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qëndrore me vetëqeverisjen vendore”, shtohen parashikime të reja dhe përcaktohen qartë funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit, duke i bërë strukturat përkatëse në nivel vendor, përgjegjëse për kryerjen e funksioneve si vijon:

- a) krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- b) nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën

dhe emigrantët shqiptarë;

c) dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare;

ç) dhënien e ndihmës e të informacionit për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve;

d) koordinimin e bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.

Referuar këtyre ndryshimeve ligjore, por edhe situatës aktuale institucionale mbi menaxhimin e çështjeve që lidhen me migrantët e kthyer dhe diasporën, të krijohen struktura dhe politika të përshtatshme në lidhje me migracionin dhe statusin e diasporës shqiptare, kanë një rëndësi kyçe për nxitjen e rritjes social dhe ekonomike në Shqipëri. Nëpërmjet zbatimit të politikave të tilla, diaspora do të mund të kontribuojë në mënyrë më efektive në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe kapitalit financiar, në rritjen e ekonomisë dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Ky plan ofron informacione lidhur me diasporën dhe migracionin dhe nënvizon sfidat dhe mundësitë e pjesëmarrjes më gjithëpërfshirëse të diasporës në përmirësimin dhe zhvillimin e gjendjes ekonomike në vend.

Tematika kryesore e këtij dokumenti lidhet me hartimin e një manuali me objektiva strategjike e masa konkrete, për përfshirjen e migracionit dhe diasporës në procesin e planifikimit të detajuar vendor, si dhe në hartëzimin e aktorëve të interesit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e migracionit dhe diasporës.

METODOLOGJIA

Metodologjia e ndjekur për hartimin e Planit Vendor të Veprimit mbështetet në tre shtylla kryesore si:

1.1 Analizimi dhe vlerësimi i nevojave dhe potencialit të target grupit të cilit i adresohet Plani Vendor i Veprimit.



a) vlerësimin e diasporës dhe të rikthyerve në kontekst lokal u realizua nëpërmjet mbledhjes së të dhënave nga spotertelet e migracionit pranë Agjencive Rajonale të Punësimit dhe Aftësive dhe informacionit pranë

institucioneve publike respective. Analiza bazohet në identifikimin e nevojave dhe ndërlidhja me shërbimet e ofruara nga pushteti vendor.

b) vlerësimi i kapaciteteve institucionale dhe të burimeve njerëzore në nivel bashkie për trajtimin e çështjeve të migracionit dhe diasporës.

1.2 Studimi i kuadrit strategjik, ligjor dhe institucional në nivel kombëtar dhe vendor. Vend të rëndësishëm zë e gjithë reforma shtetërore për diasporën, me një paketë të plotë ligjesh. Pjesë përbërëse e kësaj pakete janë po ashtu edhe dy strategji të suksesshme për diasporën dhe baza ligjore e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve po ashtu të rëndësishme funksionale për çështjet e diasporës si: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës.

Në kuadër të mirëqeverisjes së migracionit dhe diaporës u konsultuan dhe Strategjia Kombëtare për Migracionin, ligji “Për të huajt”, ligji “Për shtetësinë”, ligji “Për vetëqeverisjen vendore” dhe aktet nënligjorë të këtij kuadri ligjor, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

1.3 Zhvillimi i një plani objektivash dhe masash duke mbajtur në konsideratë përputhjen e kuadrit politik, strategjik dhe ligjor me analizën e nevojave konkrete. Rezultatet dhe idikatorët për matjen e tyre janë në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Zhvillimit të Territorit.

Metodat e përdorura:



Krijimi i një grupi pune të dedikuar për hartimin dhe konsultimin e planit, me përbërje ngspecialist të migracionit dhe diasporës, specialist për çështjet juridike dhe specialist të kostimit dhe buxhetit në nivel bashkie.

Fokus grupe në nivel vendor, diskutime dhe mbledhja e informacionit në fokus grupe nga institucionet publike në nivel vendor për të dakorteëuar fushat e veprimit, objektivat dhe masat.

Konsultimi i Planit Vendor të Veprimit me bashkitë e tjera të pilotuara për hartimin e Planeve Vendore për migracionin dhe diasporën.

Konsultimi publik i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën.

KUADRI STRATEGJIK NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

Masat konkrete të parashikuara në planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën bashkërendojnë me dokumenta strategjike më të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019-2022

Strategjia e Migracionit parashikon koordinimin dhe bashkërendimin e mirë institucional në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e politikave të migracionit më qëllim arritjen e objektivave dhe prioriteteve kryesore. Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën shtrihet në një linjë veçanërisht me një prej objektivave kryesore strategjike që është zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik në nivel kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2018-2024

Një dokument tjetër strategjik me të cilin planet vendore të veprimit shtrihen në të njëjtën linjë është Strategjia Kombëtare e Diasporës, e cila ka si qëllim sigurimin e një politikë gjithëpërfshirëse për diasporën. Kjo strategji synon mbështetjen e migrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme dhe synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve që jetojnë jashtë vendit. Po ashtu nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Plani i Veprimit 2019 - 2022

Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën janë në një linjë me një prej prioriteteve kryesore të Strategjisë për Punësim dhe Aftësi siç është: nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial, nxitja e ri-integrimit në tregun e punës, ngritja e një mekanizmi monitorues, i cili gjurmon kategoritë vulnerabël dhe të përjashtuar nga shoqëria në Shqipëri, duke përfshirë dhe ato që janë prekur nga emigracioni. Planet vendore janë në një linjë dhe me Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesave për integrimin evropian të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016-2020

Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën janë në përputhje me vizionin strategjik të SKZHI-së për të krijuar një sistem efektiv të qeverisjes së migracionit në Shqipëri.

Marrëveshja globale për migracionin (GCM-Global Compact for Migration)

Shqipëria ka mirëpritur Marrëveshjen Globale për Migracionin dhe objektivat e saj që në vitin 2018. Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën qëndrojnë në një linjë me disa prej objektivave të parashikuar në GCM si: i) Sigurimi i shërbimeve bazike për emigrantët; ii) Fuqizimi i migrantëve dhe shoqërisë për të realizuar përfshirjen e plotë dhe kohezionin social; iii) Krijimi i kushteve për migrantët dhe diasporën që të kontribuojnë plotësisht për një zhvillim të qëndrueshëm në vend.

Agenda për Zhvillim të Qëndrueshëm SDG (Sustainable Development Goals)

Shqipëria është një nga vendet që ka vendosur Axhendën 2030 si pjesë të prioriteteve të veta kombëtare. Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën janë në një linjë me disa prej objektivave të parashikuara në SDG si : i) Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë; ii) Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit; iii) Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

PLANET VENDORE TË BASHKISË KORÇË

Plani i Përgjithshëm Vendor 2016-2031

Plani i Përgjithshëm Vendor e paraqet Korçën me infrastrukturë dhe mobilitet multimodal të integruar, me prosperitet të lartë punësimi në Ballkan, që konkuron në nivel ndërkombëtar përmes investimeve innovative me anë të nxitjes së një planifikimi të qndrueshëm territorial ekonomik. Nëpërmjet këtij plani synohet krijimi i kushteve të përshtatshme me të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike sociale për të gjitha kategoritë sociale.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021- 2025

Ky plan sjell promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përmes masave specifike. Ky plan, vjen si një dokument vijues i PKVPAK 2016-2020.

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022

Një instrument që do të garantojë zbatimin e parimeve të mirëqeverisjes dhe do të mundësojë integrimin dhe gjithëpërfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane në këtë bashki. Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, synon dhe promovon: nxitjen dhe përfshirjen sociale, reagim ndaj situatave të vështira social-ekonomike dhe emergjente për pakicat rome dhe egjiptiane përfshirjen e pakicave në identifikimin e nevojave dhe hartimin e masave, dhe forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve: bashkisë dhe institucioneve qendrore, organizatave të shoqërisë civile, aktivistëve dhe

grupeve komunitare.

Plani Operacional Qendra Komunitare Korçe 2020-2021, përmes Planit Social të saj, Bashkia Korçe ka si mision të vendosë fokusin tek ofrimi i shërbimeve të standartizuara dhe cilësore të kujdesit shoqëror, për të mbuluar nevojat sociale në rritje, të grupeve në nevojë dhe pakicave.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023, synon hartimin e një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socioekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve europiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

PROFILI I BASHKISË KORÇË

Korça e shtrirë në pjesën Juglindore të vendit, përbëhet nga 7 Njësi Administrative, si: Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj e Drenovë. Me një pozitë gjeografike tejet të favorshme, kufitare me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, rajoni i Korçës është një nga qendrat më të rëndësishme kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë dhe një nga zonat më të preferuara për shkak të bukurisë që mbart dhe mundësive turistike që ofron.

Korça ka një reliev dhe natyrë që ka favorizuar shumë sektorë të ekonomisë, kryesisht bujqësinë. Korça ka fushën bujqësore të dytën për nga madhësia në Shqipëri, gjë e cila e bën këtë sektor jo vetëm të rëndësishëm për ekonominë e rajonit, por dhe fuqinë kryesore vendase.

Gjithashtu, industria e konfeksioneve, përmendim këtu pazarin e Korcës, është tejet i njohur në llojin e tij dhe është unik në Shqipëri, duke e bërë kështu sektor dhe qytetin e Korçës një nga atraksionet kryesore për turizëm. Një tjetër sektor favorizues në ekonominë e këtij qyteti është dhe sektori agropërpunues. Korça është një nga prodhuesit më të mëdhenj të mishit, bulmeteve, pijeve alkolike dhe joalkolike, përpunimit të kërmillit e më tej. Për të vijuar me sektorin e ndërtimit dhe turizmit, që përbën dhe esencën e këtij rajoni.

Në Korçë zhvillohet turizmi 4 stinor, mbushur me aktivitete të shumta si: Paniri i Pranverës, Karnavalet e Korçës, Festa e Birrës, Festivali i Vjeshtës, Korça Kult, apo dhe aktivitete të ndryshme teatrore. Të gjitha këto jo vetëm që zhvillojnë jetën ekonomiko-kulturore të qytetit, por tërheqin shumë vizitorë të huaj nga diaspora, të cilët hapin rrugën e rrisin mundësitë për investime dhe zhvillimin e tregtisë në një nivel më të lartë,

duke rritur impaktin në të gjithë rajonin e Ballkanit, me vëmendje të shtuar në bashkinë Korçë.

Një rajon si bashkia Korçë me një trashëgimi të madhe kulturore, arsimore, artistike e muzikore, me institucione arsimore universitare, me histori të bazës së zhvillimit të qytetërimit dhe kulturës e arsimit për gjithë Shqipërinë, disponon potencial të konsiderueshëm për ti ofruar banorëve të zonës së saj, por edhe rajonit rreth saj, mundësira të shumta. Është fakt tashmë se diaspora e Korçës është tejet e pasur, me integritet të lartë dhe e aftë për të lobuar dhe mbështetur zhvillimin e vendit të tyre.

Në Korçë veprojnë në mënyrë aktive shumë shoqata të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime në fushën e migracionit dhe diasporës, të cilat suportojnë vazhdimisht këtë kategori për integrim dhe riintegrim në jetën shoqërore, sociale ekonomike. E megjithatë vërehet një shkëputje e diasporës dhe migrantëve me vendin e origjinës, duke thelluar hendekun e krijuar nga migrimet e vazhdueshme ndër vite. Për këtë arsye, ky plan do të jetë dokumenti bazë që do të shërbejë aq sa është e mundur për adresimin dhe përmirësimin e sfidave e problematikave të deritanishme për përfshirjen e diasporës apo riintegrimin e migrantëve të kthyer, me qëllim krijimin e potencialit të nevojshëm për zhvillimin e ekonomik e social të bashkisë Korçë.

Lidhur me migracionin e brendshëm në Korçë gjatë viteve 2011-2019 popullsia ka qenë 220,357 persona, nga ku 22,406 persona kanë migruar. Konkretisht struktura e familjeve shqiptare me anëtarë të kthyer që kanë qëndruar jashtë për më shumë se 12 muaj, nga Shqipëria me gjithë familjen në Korçë shënon 7.6 % të rikthyer në vitin 2019¹.

¹ **Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri**, 2020, faqe 28, 35, 45
http://www.instat.gov.al/media/7969/zhvillimi_i_anket%C3%ABs_komb%C3%ABtar_e_t%C3%AB_migracionit_n%C3%AB_familje_alb.pdf

Bashkia Koçë me funksionet e shtuara në fushën e diasporës dhe migracionit, nëpërmjet drejtorisë përkatëse, ka përgjegjësi për rritjen e kapaciteteve/aktiviteteve dhe eventeve të bashkisë në skicimin dhe menaxhimin e programeve dhe projekteve lokale në dobi të qytetarëve, si dhe në aftësinë për të thithur fonde për të financuar këto projekte në bashkëpunim me donatorët dhe grupet e interesit.

ANALIZA S.W.O.T

PIKAT E FORTA

- Pozita gjeografike e Korçës
- Zhvillimin e turizmit gjithë stinor, Voskopojën dhe Dardhën,
- Trashëgimi të madhe kulturore në të gjitha fuashat, duke filluar që nga arsimi, arti, mjekësia, muzika, teatri, etj.
- Prania e institucioneve arsimore si Universitetet dhe Qëndrat e Formimit Profesional, janë një ndër faktorët kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë të qytetit, por edhe motiv për most ë rritur numrin e migracionit.
- Zhvillimi rural dhe bujqësor është një tjetër faktor për rritjen e ekonomisë,
- Eksporti i mallrave është një nga hallkat më kryesore për zhvillimin e ekonomisë për gjithë zonën Jug-Lindore..

MUNDËSITË

- Tregti me vendet fqinje, gjë e cila çon në rritjen e ekonomisë
- Diasporë e pasur, me integritet të lartë, në gjëndje për të lobuar për vendin e tyre.
- Marrëveshje dy ose shumëpalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe vendit ku jeton Diaspora për garantimin e pensioneve dhe kthimin në atdhe të pensionistëve.
- Turizmi i Diasporës, ku përfshihet turizmi mjekësor, turizmi në lidhje me biznesin, turizmin e trashëgimise.

PIKAT E DOBËTA

- Nuk ka te dhena per migracionin dhe diasporen
- Nuk ka një qëndër informimi pranë bashkive për investime të mundshme nga Diaspora
- Moskoordinimi i pushtetit lokal me atë qëndror.
- Mungesa e procedurave per transaksionin e te ardhurave që do të investohen pranë bashkisë përkatëse.
- Garantimi i shërbimeve sociale per integrimin/riintegrimin e migranteve te kthyer dhe diaspores.

KËRCËNIMET

- Imigrimi (mungesa e qendrueshmerise te popullsisë)
- Mungesa e fondeve buxhetore per realizimin e planeve te ndryshme per riintegrim.
- Shkeputja e diaspores me vendin e origjinës
- Emigrimi
- Papunësia
- Veset sociale
- Renie e numerit të krahut të punës dhe profesionistëve të rinjë.

QËLLIMI I PLANIT VENDOR

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporës, është që të krijojë dhe fuqizojë infrastrukturën e nevojshme për qeverisjen efektive, koordinimin ndërinstytucional dhe orientimin e duhur të diasporës dhe migracionit, duke i bërë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik vendor.

Bashkia Korçë ofron mundësi të barabarta për qytetarët e saj, pavarësisht vendodhjes së tyre, punon për nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe integrimin me të drejta të plota dhe të barabarta të qytetarëve të saj. Përmes këtij plani bashkia ka si mission “të vendosë fokusin tek ofrimi I shërbimeve dhe lehtësirave në realitetin ekonomik-social.

Qeverisja e mirë dhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm janë në themel të asaj çka pushteti vendor duhet të sigurojë për qytetarët. Për këtë nevojitet një përmirësim i vazhdueshëm i menaxhimit të të gjitha burimeve vendore, forcimi i planifikimit strategjik, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, si dhe rritja e pjesmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.

OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR KORÇË

Bashkia Korçë do i realizojë detyrat funksionale dhe ligjore për çështjet e diasporës dhe migracionit, në mënyrë që të arrijë objektivat e parashikuara ne 5 fusha veprimi si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT	OBJEKTIVAT
A.Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit	A.1 Forcimi i strukturave vendore per menaxhimin e diasporës dhe migracionit
	A.2 Të rriten dhe të zhvillohen kapacitete të burimeve njerëzore në instiucionet vendore për çështje të diasporës dhe migracionit
	A.3 Të krijohen lidhje të qëndrueshme me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e kthyer dhe pushtetit vendor
	A.4 Zhvillimi i mekanizmit të bashkëpunimit me institucionet qëndrore, vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë fokus për çështje të diasporës dhe migracionit
B.Shërbimet sociale dhe publike vendore.	B.1 Informimi i vazhdueshëm për të drejtat dhe detyrimet ligjore
	B.2 Garantimi i shërbimeve sociale për integrimin/riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe diasporës

C.Zhvillimi ekonomik vendor	C.1 Identifikimi dhe publikimi për diasporën i nevojave vendore për investime publike
	C.2 Garantimi i mbështetjes për realizimin e investimeve publike dhe private nga diaspora dhe migrantët e kthyer
	C.3 Lehtësimi i procedurave për investimet e reja të diasporës.
D.Veprimtaritë kulturore dhe artistike	D.1 Promovimi i kontributit dhe vlerave të diasporës në fushën artistike dhe kulturore të bashkisë
E. Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike me donatorët	E.1 Vendosja e sistemit për bashkëpunim dhe koordinim të projekteve me përfaqësuesit e organizatave, donatorë dhe ofruesit e shërbimeve
	E.2 Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe asistencës teknike.

Për realizim sa më efektiv, fushat e veprimit kanalizojnë problematikat dhe proceset e tjera të veprimtarisë së bashkisë në objektiva, të cilat përkthehen në masa konkrete të matshme, të realizueshme dhe të monitorueshme.

FUSHA E VEPRIMIT A:

Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit, është një proces i cili realizohet nëpërmjet forcimit të strukturave vendore duke zhvilluar kapacitetet e burimeve njerëzore në institucionet vendore dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet e pushtetit qendror dhe organizata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, në mënyrë që të realizohet një urë e qëndrueshme bashkëpunimi me diasporën. Çdo fazë e këtij procesi duhet të kryejë një identifikim real të nevojave konkrete, jo vetëm në bazë trajnimesh dhe kurrikulash për çështjet e diasporës dhe migracionit, por edhe në një nivel më të prekshëm, duke ndjekur programe të shkëmbimit të eksperiencave në vendet me histori më të pasur në fushën e menaxhimit të resurseve të diasporës.

Në mënyrë që të realizohet koordinimi i duhur dhe efektiv midis institucioneve dhe organizatave, krijimi i databazës së institucioneve qendrore, organizatave ndërkombëtare me detyra funksionale për çështjet e diasporës dhe migracionit, do të lehtësojë këtë proces, duke përcaktuar rrugët e komunikimit për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë periodike. Sipas të njëjtit model, por edhe për të krijuar akses më të lehtë, do të krijohet baza e të dhënave për organizatat e komiteteve të diasporës, me një hapësirë të dedikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Kjo platformë do të të nxisi një ndërveprim të rrjetit të profesionistëve të fushave të ndryshme, bizneseve dhe organizatave të diasporës, nëpërmjet takimeve periodike.

FUSHA E VEPRIMIT B:

Në fushën e shërbimeve publike dhe sociale vendore, ky plan ka objektiva kryesorë informimin e vazhdueshëm të diasporës dhe migrantëve të rikthyer, si dhe garantimin e shërbimeve sociale për integrimin dhe riintegrimin e tyre. Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet hartimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese, organizimit të

fushatave ndërgjegjësuese për shërbimet sociale publike që përfitojnë qytetarët e rikthyer nga migracioni dhe diaspora, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Shërbimet publike sociale vendore, duhet tju garantohen subjekteve të këtij plan veprimi, nëpërmjet përfshirjes së punonjësve social të trajnuar në ofrimin dhe referimin për mbështetje në strukturat e posaçme vendore, qëndrore apo dhe organizata të shoqërisë civile.

FUSHA E VEPRIMIT C:

Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor plani ka objektiva kryesorë: identifikimin dhe publikimin e nevojave vendore për investime publike nga diaspora dhe migrantët e kthyer, garantimin e mbështetjes për realizimin e këtyre investimeve publike, si dhe lehtësimin e procedurave për kryerjen e tyre.

Realizimi i këtyre objektivave do të arrihet nëpërmjet promovimit të të gjitha planeve strategjike të bashkisë Korçë, në mënyrë që të realizohet procesi njohës së nevojave për investime në përputhje me parashikimet në strategji më gjithëpërfshirëse, duke respektuar përcaktimet e ndryshme ligjore. Këto procese njohëse do të kryhen nëpërmjet takimeve, konferencave të ndryshme më të gjithë aktorët e përfshirë, duke ju parashtruar informim dhe këshillim mbi kuadrin ligjor, institucional për zhvillimin e investimeve në Shqipëri.

Realizimi i investime në këtë kontekst, do të kryhet më së miri nëpërmjet përcaktimit të një procedurë më e thjeshtuar për donacionet nga diaspora, duke ofruar asistencë për plotësimin e dokumentacionit për aplikim, si dhe duke aplikuar masa lehtësuese në të gjitha fazat.

FUSHA E VEPRIMIT D

Në fushën e veprimtarive kulturore dhe artistike, ky plan ka objektiv kryesor promovimin e kontributit dhe të vlerave të diasporës në një nivel gjithpërfshirës. Objektiv i cili do të realizohet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve, koncerteve, panairove, me pjesëmarrjen e diasporës, si dhe realizimin e vizitave të ndryshme për mbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare të diasporës.

FUSHA E VEPRIMIT E

Fusha e koordinimit të ndihmës financiare dhe teknike me donatorët, do të realizohet dhe përmirësohet nëpërmjet vendosjes së një sistemi për bashkëpunim dhe koordinimin të projekteve me përfaqësuesit e organizatave, donatorë dhe ofruesit e shërbimeve. Një sistem i tillë do të ndihmojë dhe subvencionojë biznese të reja nëpërmjet një granti të dedikuar. Gjithashtu, ky objektiv do të arrihet nëpërmjet hartëzimit dhe vendosjes së kontaktit me të gjitha projektet e diasporës dhe migracionit dhe organizatat që do ti implementojnë ato.

Një databazë me të gjitha projektet dhe organizatat implementuese, do të lehtësojë dhe do të realizojë koordinimin e aktiviteteve ndërmjet organizatave dhe bashkisë, si dhe do të realizojë më së miri shkëmbimin e informacionit mes tyre.

PLANI I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2022-2025

Fusha e veprimit A.Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit: Adresimi i nevojave të të rikthyerve dhe diasporës për shërbime sociale publike në nivel vendor					
	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objektivi 1.1: Forcimi i strukturave vendore për menaxhimin e diasporës dhe migracionit	a) Hartimi dhe miratimi i përkrahimit të punës për specialistet e strukturës	2022	SMD	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Përkrahime pune të strukturës të hartuara	Përkrahimet e punës në të aprovura në dokumentat e drejtorisë
	b) Hartimi dhe miratimi i procedurave standarte të punës	2022	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	SMD	Miratimi i procedurave standarte të punës	Kopje e procedurave standarte të miratuara
Objektivi 1.2: Të rriten dhe të zhvillohen kapacitetet e burimeve njerëzore	a) Hartimi i një kurrikule trajnimit për institucionet publike vendore të cilat	2022	SMD/Drejtoria e burimeve njerëzore	ASP/OSH C/Donatorë	Trajnime të ndjekura nga stafi i Njësisë.	Modulët e trajnimit Fotot nga trajnimet.

në institucionet vendore për çështje të diasporës dhe migracionit	ofrojnë shërbime për të rikthyerit dhe diasporën				Program i detajuar në funksion të shërbimit të target grupit të synuar.	
	b)Organizimi i pjesëmarrjes në trajnime me fokus diasporën dhe të rikthyerit	2022-2025	SMD/Drejtoria e burimeve njerëzore	ASPA/OSHC/Donatorë	Staf i trajnuar me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për diasporën dhe migracionin	Certifikatat e pjesëmarrjeve në takime; Foto nga trajnimet.
Objektivi 1.3: Të krijohen lidhje të qëndrueshme me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer	a)Krijimi një databaze të organizatave/komuniteteve të diasporës	3 muaj (do të pasurohet vazhdimisht)	SMD	AKD/DHB D	Një databazë me të dhëna në bashkëpunim me OJF që vepron në	Databaza e organizatave dhe komuniteteve të diasporës.

					diasporë.	
	b) Krijimi i një databaze për qytetarët e rithyer nga migracioni	2022-2025	SMD	NJAV AKPA/DSH S/ OSHC	Një database me të dhëna në bashkëpunim me administratorët e Njësive Vendore dhe Shërbimin Social	Tabela me të dhënat statistikore të grumbulluara
	c) Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizatat e diasporës	2022	SMD	AKD/DHB D	Dy marrëveshje të nënshkruara me organizatat e diasporës mbi	Kopje të marrëveshjeve

					format e bashkëpunimit me bashkinë.	
Objektivi 1.4. Zhvillimi i mekanizmit të bashkëpunimit me institucionet qëndrore, dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë fokus çështje të diasporës dhe migracionit	a) Shkëmbimi periodik i informacionit midis njësisë të qeverisjes vendore dhe MB/Agjencisë Kombëtare të Diasporës	çdo 3 muaj	SMD	AMVV/AKD	Krijimi i një rrjeti institucional me aktorët kryesorë në funksionin të databazës së migracionit dhe diasporës. Raportimi në afate kohore mbi updatet e të dhënave disponuese dhe raporteve tek MB dhe	E-maillet e shkëmbyera; Kopje të raportimeve

					AKD	
	b) Organizimi i takimeve periodike, për analizën 6 mujore me MB/AKD	2 herë në vit	SMD	AMVV/AKD	Takime periodike dhe raportimeve	Kopje nga analiza vjetore
	c) Identifikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të shoqërisë civile në nivel vendor dhe qendror	2022-2025	SMD	OSHC/AKD	Një strukturë unifikuese që do të bashkonte të gjitha organizatat	Databazë /shkëmbime

Fusha e veprimit B. Shërbimet sociale dhe publike vendore	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit: Adresimi i nevojave të të rikthyerve dhe diasporës për shërbime sociale publike në nivel vendor					
	Masat	Afati	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objektivi 2.1: Informimi i vazhdueshëm për të drejtat dhe detyrimet ligjore	a) Hartimi një manuali orientues për shërbimet publike që përfitojnë qytetarët e rikthyer nga migracioni dhe diaspora	2022	SMD	AKPA/DSH S/ OSHC	Rritje e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve të rikthyer nga migracioni dhe diaspora	Publikimi, shpërndarja e manualit orientues; Statistika mbi shërbimet e ruara.
	b) Krijimi i një platforme, ose një këndi online në faqen zyrate të bashkisë mbi procedurat dhe praktikat për: fitimin ose lënien e shtetësisë, stehimin social dhe	2022	SMD/DSHS	Drejtoria e IT	Një kënd në faqen zyrate dedikuar nevojave të migranteve dhe diasporës; Përmirësim i	Linku i faqes web ku është përfshirë platforma e dedikuar.

	ndihmën sociale				shërbimieve të ofruara për lehtësira mbi procedurat që duhet të ndiqen nga migrantët për marrje dokumentacioni	
Objektivi 2.2: Garantimi i shërbimeve sociale për integrimin/riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe diasporës	a) Zhvillimi i seancave këshillimore me migrantët e kthyer dhe diasporën	2022-2025	DSHC/SMD	AKPA/OSH C	1 seancë dëgjimore e organizuar në bashkëpunim me punonjësit e shërbimit social dedikuar të rikthyerve	Regjistrimet; E-mailet e shkëmbyera

	b) Referimi i rasteve pranë institucioneve/drejtorive/strukturave të tjera vendore, në varësi të nevojës apo shërbimit të kërkuar	2022-2025	SMD	DSHC/ OSHC	Shërbime dhe struktura të ngritura pranë Bashkisë Korçë, lidhur me regjistrimet e rasteve të referuara.	Database me të dhënat mbi rastet e referuara.
Fusha e veprimit C. Zhvillimi ekonomik vendor	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit: Investimet nga diaspora kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik vendor, rritje e investimeve me x%					
	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm

<p>Objketivi 3.1: Identifikimi dhe publikimi për diasporën i nevojave vendore për investime publike</p>	<p>a) Hartëzimi i nevojave konkrete për investime publike në 7 njësi administrative (Publikimi i procedurave administrative posaçërisht për investimet nga Diaspora)</p>	<p>2022</p>	<p>SMD</p>	<p>Drejtoria e Planifikimit</p>	<p>Përfshirja në buxhetim me pjesmarrje të njërive administrative e. Evidentimi i problematika ve në Njësitë Administrative dhe publikimi i tyre; 4 Prioritete të evidentuara në nivel Bashkie, të ndara në zona.</p>	<p>Publikimi i hartës së zonave sipas prioriteteve që kanë për zhvillimin ekonomik.</p>
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------	------------	---------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------

	b) Organizimi i konferencës së diasporës për publikimin e nevojave konkrete për investime	2022-2025	SMD	AKD/AMV V/ OSHC	1 konferencë e organizuar me qëllim lobimin dhe sensibilizim në drejtim të investimeve	Lista e pjesëmarrjeve, Foto, Temat e diskutimit.
	c) Hartimi i një procedure standarte vendore për pranimin, përdorimin, raportimin dhe auditimin e fondeve të përfituara nga diaspora	2022	SMD	Drejtoria e Financave/B uxhetit	1 procedurë standarte e hartuar	Miratimi i procedurës

Objektivi 3.2: Garantimi i mbështetjes për realizimin e investimeve publike dhe private nga diaspora dhe migrantët e kthyer	a) Informim dhe këshillim mbi kuadrin ligjor, institucional për zhvillimin e investimeve në Shqipëri/hartimi i dokumentave informues	2022-2025	SMD	Drjtoria Juridike	Të paktën 2 takime mbi këshillimin për kuadrin ligjor për investimet e diasporës; Fletëpalosje informuese të shpërndara fizikisht dhe në faqen zyrtare	Set me ligje dhe vendime të KB; Kopje e fletëpalosjeve.
	b) Ndjekja e aplikimeve, mbledhja e dokumentacionit, krijimi i dosjes së investuesit sipas nevojave konkrete	2022-2025	SMD	Drejtoria Juridike	Databaza e investimeve me dosjet përkatëse	Databaza

	c) Hartimi i një procedure standarte për zhvillimin e investimeve publike me donacione nga diaspora dhe lehtësimi i masave dhe procedurave administrative	2022	SMD	Djetoria e IT	Rritje bashkëpunimi dhe transparence në lidhje me investimet nga diaspora nëpërmjet krijimit të linkut në ueb me dokumenta për investimet nga diaspora	Linku për investimet në website
	d) Krijimi i një strukture për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të investimeve publike	2022-2025	SMD		Strukturë e posaçme e ngritur e mbi monitorimin dhe transparencën	Vendimi mbi strukturën e ngritur dhe anëtarët e saj

					për investimet nga Diaspora.	
Objektivi 3.3: Lehtësimi i procedurave për investimet e diasporës (reduktimi i taksave vendore /përsheptimi i procedurave)	a) Urdhër/Vendim i KB për uljen e taksave vendore për investimet	2022	SMD	KB	Mbështetje e ekonomisë lokale nëpërmjet përthithjes së investimeve nga Diaspora; Rritje e bashkëpunimit me Diasporën nëpërmjet ofrimit të taksave të ulta për investime në	Vendimi i Këshillit Bashkiak i posaçëm për investimet e diasporës dhe nivelin e taksave

					vendlindje.	
	b) Urdhër/Vendim për përshpejtimin e procedurave në shqyrtimin e aplikimeve për investime nga diaspora dhe migrantët e kthyer	2022	SMD	KB	Forcimi i bashkëpunimit me Diasporën nëpërmjet shkurtimeve të afateve për procedurat e investimeve nga diaspora.	Kopje e vendimit të Këshillit Bashkiak

Fusha e veprimit D. Veprimtaritë kulturore dhe artistike	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit: 1Përcjellja dhe ruajtja e traditave dhe kulturës dibrane në diasporë. Dispora është pjesë e zhvillimit kulturor dhe artistik të bashkisë.					
	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objektivi 4.1: Promovimi i kontributit dhe vlerave të diasporës nëpërmjet artit dhe kulturës	a) Organizimi i aktiviteteve, koncerteve, panairove, me pjesëmarrjen e diaspores	2022-2025	SMD	AKD/ Pallati i Kulturës/	Të paktën 4 aktivitete në vit, të organizuar me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e diasporës.	Kalendari i eventeve me datat përkatëse; Foto nga aktivitetet.

	b) Dhënia e titujve të nderit për diasporën për kontribut të veçantë	2022-2025	BK/SMD	Këshilli Bashkiak	Vlerësimi i kontributit të diasporës	Numri i titujve Analiza mbi kriteret e vlerësimit.
	c) Realizimi i vizitave kulturore/shkëmbimev e në rajon dhe me gjerë	2022-2025	BK/SMD	AKD/AMV V	Shkëmbimi i eksperiencave në shërbim të ruajtjes së kultures dhe traditave shqiptare/dibrane	Numri i takimeve; Marrëveshjet e bashkëpunimit
Fusha e veprimit E. Koordinimi i ndihmës financiare	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit: Partneritet i qëndrueshëm me organizatat e shoqërisë civile, donatorët. Rritja e numrit të projekteve në fushën e migracionit dhe diasporës në x%.					

dhe teknike me donatorët	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Insitucioni mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objektivi 5.1: Vendosja e sistemit për bashkëpunim dhe koordinimin të projekteve me përfaqësuesit e organizatave, donatorë dhe ofruesit e	a) Hartëzimi dhe vendosja e kontaktit me të gjitha projektet e diasporës dhe migracionit	2022-2025	SMD	AKD/ AMVV/OS HC	Harta e shpërndarjes së Diasporës në botë; Lista e kontributeve dhe investimeve në vendlidje	Publikimi në Web i hartës së diasporës

shërbimeve.	b) Krijimi i një data baze me të gjitha projektet dhe organizatat implementuese në fushën e migracionit dhe diasporës	2022-2025	SMD	AKD/AMVV/OSHC/AMSH C	Databaza e organizatave dhe projektet e implementuara	Numri i takimeve me organizatat; Numri i projekteve të identifikuara.
	c) Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta dhe shkëmbimi i informacionit me OSHC	2022-2025	SMD	AKD/AMVV/OSHC/ Pallati I kulturës	Organizimi dhe evidentimi i eventeve ne kuadër të datave të posaçme për diasporën dhe migracionin	Numri i aktiviteteve të përbashkëta me OSHC, Programe etj Korrespondenca mbi shkëmbimin e informacionit për aktivitetet e përbashkëta.

	d) Hartimi, aplikimi, zbatimi i projekteve të përbashkëta me fokus migracionin dhe diasporën	2022-2025	SMD	AKD/AMV V/ OSHC	Zgjerim i partneritetit me OJF dhe organizata nga vendi dhe diaspora për projekte të përbashkëta.	Numri i projekteve të aplikuara dhe zbatuara
Objektivi 5.2: Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe asistencës teknike	a) Organizimi i takimeve mbi mbarëvajtjen e projekteve	2022-2025	SMD	AKD/OSHC	Forcim i bashkëpunimit me diasporën përmes takimeve të përbashkëta me qëllim zbatimin apo dhe monitorimin e projekteve.	Numri i takimeve me OSHC

	b) Hartimi i raporteve të rregullta për zbatimin e projekteve	2022-2025	SMD	OSHC	Rritja e transparencës	Raportet vjetore
	c) Vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe ndikimin e tyre në adresim të nevojave në nivel vendor	2022-2025	SMD	OSHC	Monitorim i rregullt mbi qëndrueshmëri në projektin.	Raportet e vlerësimit

MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT

Progresi në arritjen e objektivave do të matet nëpërmjet indikatorëve, të lidhur me objektiva dhe masa specifike, siç përcaktohet në Planin e Veprimit. Përgjegjësia për monitorimin e përfundimit në kohë të secilës masë dhe sipas parashikimit, do të qëndrojë në një drejtori udhëheqëse, e e cila ka në fushën e saj të përgjegjësisë çështjet e migracionit dhe diasporës. Për këtë qëllim, do të krijohet një grup pune me urdhër të kryetarit të bashkisë Korçë, i cili do të përcaktojë formatin dhe procedurat për raportimin dhe mbajtjen e komunikimit të rregullt me të gjitha drejtoritë, agjencitë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e masave.

Monitorimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit do të kryhet nëpërmjet hartimit të raportimeve 6 mujore nga drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e masave. Raportimet 6 mujore do të ndahen një herë në vit me gjithë institucionet lokale, qendrore dhe organizatat në një konferencë të organizuar nga bashkia.

Gjetjet dhe rekomandimet mbi ecurinë e Planit të Veprimit adresohen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.